

PAKR.nr.523/18**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.M. nga Gjilani, për shkak të veprës penale blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 229 par. 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. M.M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.202/2013 të datës 24.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 19.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F.M., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.202/2013 të datës 24.09.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.202/2013 të datës 24.09.2018, i akuzuari F.M., është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 229 par. 1 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale është gjykuar, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë, nga plotfuqishmërie e aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Të akuzuarit, gjykata i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, ashtu që të njëjtit i ka konfiskuar substancën narkotike të llojit "Marihuanë" në peshë prej 660 gr. dhe substancën narkotike të llojit "Heroinë" me sasi prej 5,5 gram, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Të akuzuarin e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 40 €, si dhe shumë prej

50 € në emër të Fondit për Viktimat e Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit av. M.M., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me burgim dhe me gjobë, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën i ka njoftuar Prokurorinë e Apelit, të akuzuarin F.M. dhe mbrojtësin e tij M.M.. Në seancën e kolegjit mbrojtësi i të akuzuarit av. M.M., pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore mbeti në tërësi pranë propozimeve në ankesë, të cilën e përkrahu edhe i akuzuari F.M.. Në seancën e kolegjit nuk prezantoi Prokurori i Apelit, edhe pse ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, prandaj, gjykata seancën e kolegjit e mbajti pa prezencë e prokurorisë konform dispozitave të nenit 390 par. 4 të KPPK-së.

Prokuroria i Apelit, përmes parashtresës me shkrim PPA/I.nr.497/18, të datës 30.10.2018, i propozoi gjykatës që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve te theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. M.M., aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par. 2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore përkitazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë. Me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. M.M., potencohet se gjykata e shkallës së parë, i ka konstatuar shumicën e rrethanave lehtësuese, mirëpo të njëjtat nuk janë vlerësuar realisht e as në masë të duhur, për çka sidomos është dashur të merret parasysh rrethanat, se nga koha e kryerjes së veprës penale e deri më tani ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, se i akuzuari është i moshës së re, ndërsa, tani përveç familjes së vetë është mbajtës edhe i familjes së vëllait të tij, i cili ka vdekur në një ndeshje të komunikacionit, prandaj, konsideron se janë rrethana këto të cilat kushtëzojnë domosdo shqyrtimin e një dënimi shumë më të butë me burgim dhe me gjobë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të dënimit kundër të akuzuarit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse ka vlerësuar të gjitha rrethanat ashtu sikur që parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPPK-së, ku si rrethana lehtësuese të akuzuarit i ka

marrë se i njëjti ka pranuar fajësinë dhe njëkohësisht është penduar për kryerjen e veprës penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepër tjetër penale, ka pasur sjellje të mirë në gjykatë, kurse si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë, ndërsa, si rrethana rënduese ka marrë shkallën e përgjegjësisë penale, e sidomos faktin se për të njëjtin është duke u zhvilluar procedurë edhe për vepër tjetër të ngjashme penale, prandaj, duke pasur parasysh rrethanat që u cekën më lartë, e sidomos faktin se për të akuzuarin është duke u zhvilluar procedurë edhe për vepër tjetër të ngjashme penale, atëherë, mënyrën e vlerësimit të rrethanave nga gjykata e shkallës së parë në tersi e aprovon edhe kjo gjykatë e sidomos kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënim në minimumin e paraparë ligjor. Prandaj pretendimet e theksuara në ankesë nga mbrojtësi nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin në zvogëlimin e mëturjeshëm të dënimit, gjegjësisht nën minimumin e paraparë ligjor, për çka konsiderojmë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë, dhe i ligjshëm nga se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikshmërisë së veprës penale, e po ashtu është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, rrethanat e rastit konkret, rezulton se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.523/2018, më dt. 19.11.2018

Procesmbajtësja,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
1. _____
Xhevdet Abazi
2. _____
Tonka Berishaj

Kryetar i kolegjit,
Fillim Skoro